



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Dep. Nr. Prot.
Dep. Br. Prot.
Dep. 2 D/DPK Prot. No. 01-3183/15
Nr. i fag. Data
Broj stranica Datum 09-10-2015
Nr. pages Date
PRISHTINE

DATË/A:	09.10.2015
REFERENC-Ë:	DPK- DPKPP-03-03/1994/15
PËR/ZA/TO:	z. Behxhet RRUQIQI Drejtor i Drejtoratit për Prokurime të Centralizuara në Agjencinë Qendrore të Prokurimit
CC:	z. Mursel RRACI Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë Qendrore të Prokurimit
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Shërbimet e Transportit Ajror ri- vlerësim "

I nderuari z. Rrukiqi ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " Shërbimet e Transportit Ajror ri-vlerësim " me numër prokurimi: AQP-15-003-211, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Shërbimet e Transportit Ajror ri-vlerësim " me numër të prokurimit: AQP-15-003-211, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetimi

Agjencia Qendrore e Prokurimit si Autoritet kontraktues, përmes Drejtoratit për Prokurime të Centralizuara ka iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull " **Shërbimet e Transportit Ajror " ri-vlerësim** me numër prokurimi: AQP-15-003-211, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.23.04.2015. Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë Procedurë të hapur, kontratë të llojit shërbime me vlerë të madhe.

Në bazë të udhëzimit administrativ nr.02/15 për procedurat e centralizuara i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës është aprovuar lista e artikujve të përdorimit të përbashkët ndërsa, Agjencia Qendrore e Prokurimit është autorizuar të zhvillojë procedurën për aktivitetin e prokurimit Shërbimet e Transportit Ajror në emër të vetin dhe të 84 Autoriteteve Kontraktuese të cilat kanë bërë kërkesë që ti bashkëngjiten kësaj kontratë publike kornizë.

Agjencia Kundër Korrupsionit me dt.21.07.2015, ka paraqitur kërkesë për dokumentacion ku ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues që ta dorëzoj në Agjenci tërë dokumentacionin për këtë procedurë të prokurimit. Autoriteti Kontraktues AQP me dt.21.09.2015 ka dorëzuar tërë dokumentacionin e kërkuar. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë tender AKK ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim: Për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e Tenderit e kanë tërhequr gjithsej 12 Operator ekonomik, ndërsa 5 prej tyre i kanë dorëzuar ofertat e tyre për këtë kontratë.

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve të dt.19.06.2015, Komisioni për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve ka konstatuar se ka vetëm një Ofertë të përgjegjshme e cila i plotëson kërkesat sipas Dosjes së këtij tenderi, andaj Komisioni vlerësues ka rekomanduar Zyrtarin përgjegjës të prokurimit që në pajtim me nenin 32 paragrafi 5 të vazhdoj me revokim të nenit, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me dt.19.06.2015 ka paraqitur njoftim zyrtar në Komisionin Rregullativ për Prokurimin Publik për përjashtim të kërkesës me më pak se dy tender të përgjegjshëm. Lidhur me këtë vlerësim ka pasur ankesa nga disa Operator ekonomik. Me dt.29.07.2015 ka nxjerrë vendim Organi Shqyrtues i Prokurimit ku e ka urdhëruar Autoritetin Kontraktues që lëndën ta kthej në ri-vlerësim.

Duke u bazuar në raportin e ri-vlerësimit të tenderëve të dt.11.08.2015 i cili është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, Komisioni ri-vlerësues pas vlerësimit të ofertave ka konstatuar se ka vetëm një ofertë dhe e cila sipas Komisionit ri-vlerësues është e përgjegjshme, pasi që i plotëson të gjitha kërkesat konform Dosjes së Tenderit. Komisioni ri-vlerësues ka rekomanduar Zyren e Prokurimit se meqenëse kemi vetëm një ofertë të përgjegjshme që të bëj anulimin e aktivitetit të prokurimit në pajtim me nenin 32 pika 4 të Ligjit për Prokurimin Publik- LPP.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit pas marrjes së rekomandimit nga ana e Komisionit ri-vlerësues i njëjti i ka paraqitur një deklaratë mbi refuzimin e rekomandimit të komisionit ri-vlerësues në lidhje me këtë tender dhe ka vendosur që të vazhdojë tutje me një Operator ekonomik.

Me dt.13.08.2015 Zyrtari përgjegjës i prokurimit i AQP-së e ka njoftuar KRPP-në për përjashtim të kërkesës më pak se dy tender të përgjegjshëm duke i cekur arsyet se pse bënë revokimin e nenit ku edhe e ka shpallur fitues Operatorin e vetëm i cili ka qenë i përgjegjshëm, Zyrtari përgjegjës i prokurimit ka dhënë arsyetimin si më poshtë:

Agjencia Qendrore e Prokurimit ka udhëhequr këtë aktivitet të prokurimit në emër të vet dhe në emër të 84 Autoriteteve kontraktuese sipas UA nr.02/2015. AQP ka publikuar këtë tender me procedurë të hapur dhe ka pranuar 5 oferta. Nëse e krahasojmë këtë aktivitet të prokurimit me aktivitetet e udhëhequra nga Autoritetet tjera kontraktuese rezulton se asnjë AK nuk ka pranuar më shumë se 4 oferta. Konsiderojmë që nuk ka pasur kritere diskriminuese pasi që kemi mbajtur konferencën para- ofertuese dhe i kemi përmirësuar komentet që janë bërë nga Ofertuesit.

Nuk ka pasur asnjë diskriminim apo favorizim të OE-ve në specifikime teknike apo në kërkesat e përzgjedhjes OE janë eliminuar kryesisht për shkak të gabimeve teknike vlen të ceket se një ofertë ka qenë e përgjegjshme nga ana administrative, teknike dhe financiare por është eliminuar për shkak të çmimit jo normalisht të ulët. Gjithashtu duhet cekur se edhe sikur të mos ishin eliminuar OE për shkak të gabimeve teknike rezultati i këtij tenderi nuk do të ndryshonte, Çmimi i Operatorit ekonomik i propozuar për kontratë është çmim i arsyeshëm dhe na siguron zbatim të kontratës dhe nuk është çmim më i lartë se çmimi i tregut (çmimi i tregut min.15 € për biletë, ndërsa oferta 1.27 €. Konsiderojmë se shpenzimet në kohë dhe para nga OE dhe AQP në përgatitjen e këtij tenderi janë të larta dhe parimi i parë i prokurimit siç është efikasiteti mund të dëmtohet nëse e ri tenderojmë. Edhe nëse ri tenderohet ky aktivitet i prokurimit kjo përsëritje nuk do të rezultojë në ngritje të numrit të tenderëve, pasi që specifikimet e para të kontratës nuk do të ndryshohen dhe ri-tenderimi vetëm do të sillte humbje AQP-së dhe OE –ve të interesuar dhe besojmë se do ta zvogëlonte numrin e tenderueseve.

Si përfundim, meqenëse është revokuar neni 34.2 i LPP-së herën e parë vendos që të revokoj këtë nen edhe këtë herë pasi që Oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë do të shpërblehet me kontratë dhe sigurohet parimi i trajtimit të barabartë për të gjithë Operatorët ekonomik. Ky ka qenë arsyetimi i dhënë nga ana e Zyrtarit përgjegjës të prokurimit në shkresën që i ka dërguar Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se një veprim i tillë nga ana e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit bie ndesh me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës më saktësisht me nenin 32 Rregullat e Përgjithshme paragrafin 4 dhe 5. Sipas këtij neni theksohet në mënyrë decisive se nëse, gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit, pranohen më pak se dy (2) tenderë të përgjegjshëm ose, kur është e zbatueshme, kërkesa për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues duhet të anulojë aktivitetin e prokurimit. Pavarësisht nga kërkesat e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni kur më pak se dy tender të përgjegjshëm apo kërkesa për pjesëmarrje janë dorëzuar në përgjigje të një procedure të hapur, procedure të kufizuar apo procedure të

negociuar pas publikimit të njoftimit për kontratë, me kusht që a) specifikimet e para të kontratës nuk ndryshohen b) që autoriteti kontraktues ka demonstruar që për arsye të konkurrencës shumë të kufizuar në treg për kontratën në fjalë, një procedurë e re e hapur, e kufizuar ose e negociuar pas publikimit të njoftimit për kontratë nuk do të rezultojë në ngritje të numrit të tenderëve përgjegjës, kur është e aplikueshme, kërkesat për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues mund të anuloi këtë kërkesë. KRPP duhet të njoftohet nga autoriteti kontraktues përkatës brenda dy ditëve nga dita e vendimit për anulimin e kërkesës. Mirëpo pavarësisht se LPP lejon revokimin e kërkesës me më pak se dy tender të përgjegjshëm, megjithatë në rastin konkret Autoriteti Kontraktues nuk ka demonstruar se ekziston një konkurrencë shumë e kufizuar për këtë lloj shërbimi dhe fakti se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit ka pasur 12 Operator ekonomik të cilët e kanë tërhequr Dosjen për këtë tender dhe 5 prej tyre kanë ofertuar tregon shumë qartë se ka numër të mjaftueshëm të Operatorëve ekonomik të interesuar që të kryejnë shërbimet e tilla, pra në rastin konkret nuk ekziston konkurrencë e kufizuar. Arsyet të cilat i ka theksuar Zyrtari Përgjegjës i prokurimit konsiderojmë se nuk qëndrojnë dhe nuk kanë mbështetje në dispozitat e LPP-së.

Me dt.25.08.2015 Autoriteti Kontraktues AQP ka bërë njoftimin për dhënie të kontratës i cili është publikuar në web të KRPP-së me të cilin është shpallur fitues ***Operatori ekonomik i vetmi i cili sipas Komisionit ri-vlerësues ka qenë i përgjegjshëm***. Kundër njoftimit për dhënie të kontratës kanë parashtruar ankesë 2 Operator ekonomik me pretendimin se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo – normalisht të ulëta, mirëpo OSHP ka nxjerrë vendim me dt.16.09.2015 me të cilin e ka vërtetuar vendimin e Autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës dhe e ka refuzuar njëren ankesë, ndërsa ankesën tjetër e ka miratuar pjesërisht mirëpo për shkak se Operatorët ankues janë më të shtrenjtë në krahasim me OE të rekomanduar për kontratë Organi Shqyrtues i Prokurimit vlerëson se Operatorit të cilit i është miratuar pjesërisht ankesa nuk ka interes material për shkak të çmimit më të lartë mbi 273,000.00 € dhe në asnjë rrethanë nuk mund të jetë nënshkruar në kësaj kontrate. Po ashtu edhe OE tjetër ankues të cilit i është refuzuar ankesa është më çmim më të lartë mbi 82,000.00 €. Paneli Shqyrtues konstaton dhe vlerëson se është respektuar kriteri kryesor për dhënie të kontratës tenderi i përgjegjshëm më çmimin më të ulët. Në rastin konkret PSH duke pasur parasysh nenin 1 dhe 6 të LPP-së që ka për qëllim dhe lëndën e kontratës për shfrytëzimin sa më të drejtë të fondeve publike, andaj Paneli Shqyrtues, konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, është bërë në përputhshmëri me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së, pasi që është rekomanduar për kontratë OE i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Agjencia Kundër Korrupsionit ka analizuar dhe shqyrtuar edhe ofertat tjera dhe ka konstatuar se, Komisioni ri-vlerësues i ka bërë disa lëshime kur ka ri-vlerësuar se Operatori ekonomik ***NTT Euro Sky Travel Club*** nuk është i përgjegjshëm, ndërsa Zyrtari përgjegjës i prokurimit ani pse e ka refuzuar ri-vlerësimin e Komisionit ri-vlerësues duke theksuar se për këtë Operator ekonomik ka vendosur OSHP dhe se sipas saj është e përgjegjshme, ai prap se prap nuk e konsideron si të përgjegjshëm andaj është e pakuptueshme se pse ka bërë revokim neni kur e ka refuzuar

vlerësimin e komisionit ri-vlerësues për këtë Operator ekonomik. Sipas Agjencisë Kundër Korrupsionit ky Operator ekonomik nuk është i përgjegjshëm për arsyet si në vijim: Ky Operator ekonomik nuk e ka ofruar Sigurimin e Tenderit sipas kërkesës dhe formës standarde në këtë dokument të ofruar nga OE i cili emërtohet si Sigurim i garancive konsiderojmë se nuk i plotëson kushtet e një Sigurimi për tender, pasi që në këtë dokument nuk janë paraparë rastet kur mund të konfiskohet i njëjti, andaj në rast se Autoriteti Kontraktues do të kërkonte ta konfiskonte këtë Sigurim në bazë të këtij dokumenti nuk do mund ta bënte konfiskimin e këtij garancioni, andaj në këtë rast Komisioni vlerësues i cili për herë të parë e ka refuzuar këtë dokument ka vepruar drejtë, ky OE nuk ka dorëzuar një sigurim të tenderit sipas aneksit 4 të dosjes së tenderit por ka dorëzuar një sigurim i cili nuk përmban dëshmi se kur konfiskohet ky sigurim, nuk i ka tri dispozita obliguese nuk është sipas formularit standard të KRPP-së dhe i mungojnë elementet kryesore të një sigurimi të tenderit. Eksperti shqyrtues i Organit Shqyrtues i Prokurimit dhe Paneli Shqyrtues ka konstatuar se Sigurimi i Tenderit i ofruar nga ky OE i përmban elementet e nevojshme të një sigurie tenderi dhe komisioni vlerësues do duhej ti kërkonte sqarime shtesë në rast se ka pasur paqartësi, gjithashtu sipas tyre nuk është e domosdoshme që në Sigurinë e Tenderit të paraqiten raste se kur mund të konfiskohet i njëjti pasi që këto raste i ka paraparë Ligji në fuqi për Prokurimin Publik.

Tek rubrika kapaciteti teknik ose profesional kërkesa 2 është kërkuar që OE duhet të ketë së paku 5 punëtorë të kualifikuar përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të cilët duhet të jenë të trajnuar nga IATA dhe të kenë min. 6 muaj përvojë pune, Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se Operatori në fjalë ka ofruar 3 diploma të lëshuara nga IATA dhe 2 diploma tjera nga JAT Skolstvo training – Jugoslovenski Aerotransport të lëshuara në vitin 1995, lidhur me këtë AKK konstaton Komisioni ri-vlerësues ka vepruar drejtë kur ka konstatuar se nuk e plotëson këtë kërkesë konform dosjes së tenderit. Tek kërkesa 3 e të njëjtës rubrikë është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ketë qasje si agjent në sistemin kompjuterik të rezervimeve (CRS) computer reservations system amadeus, galileo, sabre ose të barsvlershme se paku për 5 punëtor, ndërsa si dëshmi është kërkuar të ofrohet një raport origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga Operatori ekonomik mbi mjetet që janë në dispozicion të OE për realizimin e shërbimeve të cilat dëshmojnë se OE ka qasje si agjent i rezervimeve në sistemin kompjuterik të rezervimeve CRS amadeus, galielo, sabre ose të barsvlershme për se paku 5 punëtor dhe ky raport duhet të përmbajë emrat e pesë punëtorëve dhe kodet e tyre kompjuterike. Ky Operator ekonomik ka ofruar një vërtetim të noterizuar të lëshuar nga AMADEUS ku dëshmohet se i ka mbi 5 punëtor me kode që kanë qasje si agjent në sistemin kompjuterik të rezervimeve CRS. Arsyetimi i Komisionit vlerësues dhe Zyrtarit përgjegjës të prokurimit ka qenë se nuk është ofruar raporti nga Operatori ekonomik, që konsiderojmë se kanë vlerësuar gabimisht dhe do duhej ta pranonin pasi që është dëshmi bindëse direkt nga Amadeus se e ka plotësuar këtë kërkesë. Sipas AKK-së dokumenti është i pranueshëm dhe me këtë plotësohet kërkesa e Autoritetit kontraktues konform dosjes së këtij tenderi.

Tek oferta e OE **Eurokoha reisen**, Agjencia Kundër Korrupsionit ka vërejtur se i njëjti gjatë vlerësimit të parë është shpallur i përgjegjshëm dhe është rekomanduar për kontratë, ndërsa nga

ana e komisionit ri-vlerësues është shpallur si i papërgjegjshëm me arsyetimin se i mungon një raport origjinali cili është kërkuar tek kërkesat teknike ose profesionale ku më konkretisht është kërkuar që OE duhet të ketë qasje si Agjent në sistemin kompjuterik të rezervimeve (CRS) Amadeus, Galielo, sabre ose të barasvlershme për së paku 5 punëtor) e ky raport është kërkuar në origjinal, ndërsa vërehet se OE në fjalë e ka ofruar një raport nga Amadeus të nënshkruar e vulosur ku janë cekur emrat e agjentëve të regjistruar me kode, mirëpo Komisioni vlerësues nuk e ka pranuar këtë raport pasi që është i skanuar e jo konform dosjes së tenderit fakt ky që e vërteton edhe Agjencia Kundër Korrupsionit.

Agjencia Kundër Korrupsionit pasi ka analizuar dhe krahasuar ofertat e Operatorëve tjerë ekonomik ka konstatuar se Komisioni vlerësues ka vepruar konform nenit 59 ku sipas Komisionit ri-vlerësues këta OE janë të papërgjegjshëm pasi që nuk i kanë plotësuar disa nga kërkesat konform Dosjes së Tenderit.

Tek oferta e Operatorit ekonomik të rekomanduar për këtë kontratë, AKK konstaton se i njëjti është i përgjegjshëm në aspektin e kërkesave administrative, ekonomike edhe teknike-profesionale, mirëpo çmimin e ofruar për primin (tarifën e shërbimit) e ka ofruar në shumë prej vetëm 1.27 € dhe ka planifikuar që nga kjo kontratë të fitoj për afërsisht 15.000.00 €. Komisioni vlerësues në bashkëpunim me Zyrtarin Përgjegjës të prokurimit dhe konsulentët e angazhuar nga projekti PLANET e kanë bërë një analizë rreth primit të ofruar nga ky Operator dhe kanë konstatuar se vetëm shpenzimet e ekzekutimit për këtë kontratë arrijnë vlerën mbi 56.000.00 € e që sipas Komisionit vlerësues nuk i mbulon as shpenzimet të cilat do t'i ketë Operatori ekonomik. Komisionit vlerësues në bashkëpunim me Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit i ka bërë kërkesë për sqarim të tenderit jo-normalisht të ulët duke kërkuar sqarim me shkrim rreth elementeve përbërëse të çmimit të ofruar. Operatori ekonomik i rekomanduar për këtë kontratë i ka dërguar sqarimet rreth çmimit të primit të ofruar duke dhënë edhe arsyetimin rreth primit i cili sipas Komisionit vlerësues nuk është i pranueshëm dhe nuk e arsyeton çmimin e ofruar, andaj Komisioni vlerësues e ka shpallur si tender jo-normalisht të ulët duke e eliminuar si të papërgjegjshëm. Ndërsa Komisioni ri-vlerësues nuk e shqyrtuar fare këtë pikë me arsyetimin se OSHP ka vendosur që nuk është tender me çmim jo-normalisht të ulët.

Agjencia Kundër Korrupsionit ka analizuar edhe ekspertizën e përgatitur nga ana e ekspertit Shqyrtues të OSHP-së të dt.23.07.2015, ku vëren se eksperti shqyrtues pas analizimit të ankesës së Altavia Travel& As Travel tashmë të rekomanduar për kontratë ka konstatuar se Komisioni vlerësues e ka shpallur si tender jo-normalisht të ulët në kundërshtim me nenin 59.4 eksperti shqyrtues ka potencuar se Autoriteti Kontraktues ka bërë llogarinë e shpenzimeve të OE ankues, duke mos i njoftuar paraprakisht se çka përfshihet në tarifën e shërbimeve. Sipas Ekspertit të OSHP-së, AK-ja nuk ka vendosur në dosje të tenderit kurrfarë sqarimi për Operatorët ekonomik, se çfarë duhet të mbulohet me tarifën e shërbimit, ndërsa në rastin konkret ka përdorur shpenzimet e OE-ve dhe e ka vlerësuar si ofertë me çmim jo-normalisht të ulët. Gjithashtu Eksperti Shqyrtues ka sqaruar se me tarifën e shërbimeve në Dosjen e tenderit nuk është paraparë

të mbulohet Sigurimi i tenderit, Sigurimi i ekzekutimit dhe nuk është paraparë të mbulohen as pagat e punëtorëve, që në rastin e konkret AK-ja ka bërë llogarinë vetëm për dy punëtor të cilët janë me parakontrata. Eksperti shqyrtues mendon se AK-ja për të përdorur tarifën e shërbimeve është dashur të vendos sqarim për Operatorët ekonomik se çfarë shpenzime duhet ti mbulojnë OE-të me tarifën e shërbimeve, ndërsa në rastin konkret Autoriteti Kontraktues për shkak të mos njoftimit të OE-ve se çka duhet të mbulohet me tarifën e shërbimeve.

Lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues Agjencia Kundër Korrupsionit konsideron se eksperti shqyrtues i ka kuptuar dhe vlerësuar gabimisht faktet, kjo për faktin se Udhëzimet se si të plotësohet lista e çmimeve në dosjen e tenderit kanë qenë shumë të qarta madje lidhur me këtë është mbajtur edhe konferenca para ofertuese ku me kërkesën e Operatorëve ekonomik është ndryshuar edhe lista e çmimeve. Më tutje eksperti shqyrtues ka vlerësuar gabimisht në rastin kur ka theksuar se në DT nuk është paraparë të mbulohet sigurimi i tenderit dhe sigurimi i ekzekutimit dhe pagat e punëtorëve, kjo për faktin se tenderuesit e kanë pasur shumë të qartë shumën e sigurisë së tenderit dhe të ekzekutimit e gjithashtu edhe shpenzimet për 5 punëtor, andaj tenderuesit është dashur që të gjitha këto shpenzime ti përfshijnë në primin e ofruar për këtë kontratë. Eksperti shqyrtues ka konsideruar se oferta e OE ankues nuk mund të konsiderohet si ofertë me çmim jo-normalisht të ulët për arsye se e ka plotësuar listën e çmimeve konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe specifikimit teknik duke mos dhënë arsye bindëse se pse nuk është çmim jo-normalisht i ulët. Për më tepër konstatimi i ekspertit shqyrtues se sigurimi i tenderit dhe sigurimi i ekzekutimit nuk mund të i'u obligohet Operatorëve ekonomik në prim ka krijuar një pabarazi në mes Operatorëve ekonomik pasi që shumica prej tyre i kanë përfshirë këto shpenzime në prim me përjashtim të Operatorit ekonomik tanimë të rekomanduar për kontratë.

Eksperti Shqyrtues i Organit Shqyrtues të Prokurimit i cili i ka bërë dy ekspertizat për këtë proces të prokurimit nuk ka arritur që as në ekspertizën e dytë të dt.08.09.2015 ti japë arsyet se pse nuk e konsideron si ofertë me çmim jo-normalisht të ulët ofertën e Operatorit ekonomik të rekomanduar për këtë kontratë e që kjo pikë ka qenë pretendimi kryesor i pikave ankimore nga parashtruesit e ankesave. Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se eksperti shqyrtues nuk ka arritur të sqarojë pikën kryesore të ankimimit e që ka qenë tenderi i ofruar me çmim jo-normalisht të ulët nga Operatori ekonomik i rekomanduar për këtë kontratë.

Sipas Agjencisë Kundër Korrupsionit, Operatori ekonomik i cili është shpërblyer me kontratë është i papërgjegjshëm dhe ka ofruar tender të pazbatueshëm, pasi që ka ofertuar me çmim të primit jo-normalisht të ulët dhe në rast se një kontratë e tillë do të ekzekutohej atëherë ekziston rrezik real që Autoritetet kontraktuese të cilat janë pjesë e kësaj kontratë të paguajnë çmime shumë të larta, pasi që në bazë të këtij primi që ka ofruar OE i rekomanduar për kontratë që nuk i mbulon as shpenzimet administrative të kësaj kontrate e që lë potencial shumë të madh që Autoriteteve kontraktuese të i'u shiten bileta për udhëtime me çmime më të larta sesa vlera reale të tregut në mënyrë që Operatori ekonomik t'i mbuloj shpenzimet e veta dhe ta realizoj fitimin e vet nga kjo kontratë. Lidhur me këtë Agjencia kundër Korrupsionit ka informacione se

Operatorët ekonomik mund ta ndryshojnë çmimin e biletës në sistem me rastin e printimit të biletës, andaj ky fakt i'u lë mundësi shumë të mëdha që Operatorët ekonomik të manipulojnë me çmime të biletave.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka analizuar me kujdes tërë dokumentacionin e tenderit konstaton se asnjëri nga Operatorët ekonomik të cilët kanë ofertuar për këtë kontratë nuk ka dorëzuar tender të përgjegjshëm, andaj Autoriteti Kontraktues do duhej ta bënte anulimin e procedurës së prokurimit. Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon Autoritetin kontraktues që në rast të ri-tenderimi të këtij aktiviteti të prokurimit ta parasheh në dosjen e tenderit mbikëqyrjen e vazhdueshme në sistemet e shtijës së biletave.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 32 Rregullat e Përgjithshme, nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe nenin 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë Kundër Korrupsionit për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !